

Në pajtim me nenin 25, paragrafi 4 të Ligjit të Veprimtarisë së Inovacionit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/13, 137/13, 41/14, 44/15, 6/16, 53/16, 190/16 dhe 64/18), Këshilli Drejtues i Fondit të Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik, në seancën e mbajtur në _____, miratoi

RREGULLOREN
për instrumentin e mbështetjes - grantet e bashkëfinancuara për shoqëritë e sapothemeluara tregtare, start-up dhe spin-of

I. Dispozitat e përgjithshme

Lënda

Neni 1

Me këtë rregullore vërtetohen kriteret e përafërta për ndarjen e mjeteve nëpërmjet instrumentit për mbështetje - grantet e bashkëfinancuara për shoqëritë e sapothemeluara tregtare, start- ap dhe spin-of (në tekstin e mëtejshëm: “Instrumenti”) si dhe mënyra e ndarjes së mjeteve, mënyra e vlerësimit të paraqitjeve të dorëzuara, mënyra e promovimit, si dhe procedura të tjera lidhur me ndarjen e mjeteve me këtë instrument.

Përkufizimet

Neni 2

(1) Në këtë rregullore, krahas përkufizimeve sipas Ligjit të Veprimtarisë së Inovacionit, përdoren edhe përkufizime dhe sqarime me këtë domethënie:

1. “**Aplikues**” do të thotë shoqëri tregtare ose ekip i personave fizikë që pranë Fondit ka dorëzuar propozimprojekt në konkurs të hapur publik për ndarjen e mjeteve sipas këtij instrumenti. Nëse si aplikues paraqitet ekip i personave fizikë, numri i personave në ekip mund të jetë maksimumi deri në pesë (5) persona fizikë dhe në rast se propozimprojekti e kalon fazën e selektimit, ekipi obligohet në afat prej 30 ditëve kalendarik pas pranimit të njoftimit për selektimin e propozimprojektit, të themelojë shoqëri tregtare ku si themelues do të paraqiten të paktën 51% të anëtarëve të ekipit.
2. “**Kontratë për ndarjen e mjeteve**” do të thotë kontratë mes Fondit dhe shfrytëzuesit të përzgjedhur, për ndarjen e mjeteve sipas këtij Instrumenti, e lidhur në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në këtë rregullore.
3. “**Komitet i miratimit të investimeve**” do të thotë komitet i themeluar në pajtim me Ligjin e Veprimtarisë së Inovacionit.
4. “**Shfrytëzues**” është aplikues i cili i përmbush kriteret e aftësisë nga kjo rregullore dhe i cili ka nënshkruar kontratë me fondin për ndarjen e mjeteve.
5. “**Plan për menaxhimin e mjedisit jetësor**” do të thotë plan për menaxhimin e mjedisit jetësor për projekte inovacioni, i përpunuar në pajtim me dispozitat në fuqi

për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe uljen e ndotjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku jepen informacione të hollësishme për masat që janë të përshtatshme përkatësisht të domosdoshme që dobitë nga Projekti të jenë maksimale, mënjanimin, kompensimin përkatësisht zbutjen e të gjitha efekteve të dëmshme ndaj mjedisit jetësor përkatësisht këto efekt të arrijnë nivelin e pranueshëm, së bashku me buxhetin dhe vlerësimin e shpenzimeve, burimi i financimit, prenotimet përkatëse institucionale dhe prenotime për ndjekje dhe njoftim që mundësojnë zbatim përkatës dhe dorëzim të informacioneve të rregullta kthyesë për harmonizimin me planin për menaxhimin e mjedisit jetësor.

6. **“Ndryshim i pronësisë së kapitalit”** do të thotë, në raport me shfrytëzuesin që është shoqëri tregtare i themeluar në pajtim me Ligjin e Shoqërive Tregtare, marrje të drejtpërdrejtë ose indirekte, graduale ose përnjëherë, të pjesëmarrjes përkatësisht të aksioneve në kryegjënë themelore të shfrytëzuesit, nga cilido person fizik ose juridik nëpërmjet shitblerjes, dhuratës, trashëgimisë (përfshirë edhe në rast të vdekjes së partnerit të shumicës së aksioneve, përkatësisht aksionar i shfrytëzuesit), likuidim, ndryshimi statusor ose lloj tjetër i kontratës ose bartjes.
7. **“Rregullore”** do të thotë instrument për mbështetje, grantet e bashkëfinancuara për start-up dhe spin-of të Fondit të Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik, i miratuar nga Këshilli Drejtues i Fondit.
8. **“Propozimprojekt”** do të thotë projekt i dorëzuar në konkurs të hapur publik për ndarjen e mjeteve sipas këtij Instrumenti të Fondit, që të financohet nëpërmjet grantit të bashkëfinancuar, sipas kritereve dhe procedurave të parapara në këtë rregullore.
9. **“Rezultate të projektit”** nënkuptojnë çfarëdo rezultate materiale ose jomateriale nga projekti, për të cilat ka të bëjë kontrata për ndarjen e mjeteve, siç janë të dhënat, njohuritë ose informacionet, në çfarëdo forme dhe të çfarëdo natyre, pa marrë parasysh nëse mund të jenë të mbrojtura ose jo, që janë themeluar nëpërmjet aktiviteteve të projektit si dhe çfarëdo të drejta ndaj tyre, përfshirë edhe të drejtat nga pronësia intelektuale.
10. **“Start-ap”** është shoqëri tregtare e themeluar nga një ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, nga themelimi i të cilës deri në momentin e aplikimit për financim, nuk kanë kaluar më shumë se gjashtë vite;
11. **“Spin-of”** është shoqëri tregtare e themeluar nga një ose më shumë persona fizikë, të punësuar/ të angazhuar ose studentë në institucionin që kryen veprimtari të arsimit të lartë përkatësisht veprimtari shkencore- hulumtuese dhe/ose persona juridikë të themeluar nga institucione që bëjnë veprimtari shkencore- hulumtuese dhe/ose nga subjekte afariste, për qëllim të eksploatimit komercial të inovacionit, e transferuar në shoqërinë e sapothemeluar tregtare;
12. **“Persona profesionale”** janë bashkëpunëtorë të jashtë profesional të angazhuar nga Fondi në pajtim me rregulloren për mënyrën e përfshirjes dhe punës së personave profesional në punën e Fondit gjatë vlerësimit dhe dhënies së mendimit profesional, për zbatimin e fazës së paraselektimit të propozimprojekteve të këtij Instrumenti.
13. **“Fazë e paraselektimit”** është faza e vlerësimit që zbatohet nga persona profesional, të emëruar nga Fondi, që e shqyrtojnë materialin, dorëzojnë vlerësim dhe mendim profesional për propozimprojektet, që përkojnë me kriteret e vlerësimit përkatësisht qëllimet e Instrumentit.

14. “**Fazë e selektimit**” është faza e vlerësimit që zbatohet nga Komiteti i miratimit të investimeve, që bën vlerësim të propozimprojekteve që e kanë kaluar fazën e para-selektimit dhe merr vendim përfundimtar të financimit nëpërmjet Instrumentit të Fondit.
15. “**Fond**” është Fondi i Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
16. “**Ndryshim statusor**” është lidhja, bashkimi dhe ndarja e shoqërisë tregtare sipas mënyrës dhe kushteve të përcaktuara me Ligjin e Shoqërive Tregtare.

Qëllimi dhe përshkrimi i instrumentit

Neni 3

(1) Qëllimi i këtij instrumentit është që të nxisë zhvillimin e inovacionit të shoqëritë e sapothemeluara tregtare nëpërmjet sigurimit të mbështetjes së domosdoshme financiare për aktivitete të hulumtimit dhe zhvillimit.

(2) Nëpërmjet këtij instrumenti pritet të nxitet zhvillimi i kulturës së marrjes së rrezikut dhe vendosjes së inovacioneve, të sigurohet mbështetje për persona juridikë që duan të zhvillojnë produkt të ri ose të përmirësuar, proces dhe/ose shërbim, si të nxitet komercializimi i rezultateve nga hulumtimet e zbatuara në suazat e institucioneve të arsimit të lartë përkatësisht institucioneve shkencore-hulumtuese.

Neni 4

(1) Mbështetja nëpërmjet këtij instrumenti do t’u jepet projekteve që kanë së paku “dëshmi të zbatueshmërisë së projektit” (proof of concept) dhe ambicie të qartë për komercializim.

(2) Instrumenti mbështet projekte që janë në fazë të konceptit të vërtetuar deri në fazën para komercializimit (paratregtare).

(3) Instrumenti dedikohet për financimin e shoqërive të sapothemeluara tregtare të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për të nxitur inovacionin të personat juridikë, zbatimin e zgjidhjeve inovative, mbështetjen e personave juridikë që kanë potencial të lartë të rritjes si dhe bartjen e rezultateve nga hulumtimet shkencore në ato aplikative përkatësisht aktivitete komercial nëpërmjet formimit të personit juridik “spin-off”.

Kriteret e përgjithshme të bashkëfinancimit nëpërmjet këtij instrumenti

Neni 5

(1) Nëpërmjet këtij instrumenti, Fondi i Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik (në tekstin e mëposhtëm: “Fondi”) siguron:

- deri 90% (nëntëdhjetë përqind) nga buxheti i përgjithshëm i projektit, por jo më shumë se 40.000 (dyzet mijë) euro në kundërvlerë denari për shoqëritë tregtare deri në 3 (tre) vite të ekzistimit deri në momentin e aplikimit ose për shoqëri tregtare që do të themelohet në afat prej 30 ditëve pas marrjes së Njoftimit për selektimin e propozimprojektit (në rastin kur si aplikues paraqitet ekipi) përkatësisht -deri 85% (tetëdhjetë e pesë përqind) nga buxheti i përgjithshëm i projektit, por jo më shumë se 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) euro në kundërvlerë denari për shoqëritë tregtare me mbi 3 (tre) e më pak se 6 (gjashtë) vite të ekzistimit deri në momentin e aplikimit.

(2) Vlera e mbetur 10% (dhjetë përqind) përkatësisht 15% (pesëmbëdhjetë përqind) nga buxheti i përgjithshëm i projektit, duhet të sigurohet nga aplikuesi.

(3) Mjetet e fituara nga Fondi me çfarëdo baze tjetër ose çfarëdo forme tjetër e ndihmës shtetërore, nuk pranohen si bashkëfinancim nga aplikuesi.

(4) Për financim janë të përshtatshme të gjitha propozimprojektet nga të gjithë sektorët, përveç për:

- veprimtari prodhuese, tregtare dhe shërbyese që nuk janë në pajtim me ligjin;
- prodhim dhe tregti me duhan, pije të destiluara alkoolike dhe produkte të ngjashme (pije që përmbajnë alkool, por nuk janë fituar me destilim, por për prodhimin e tyre mund të përdoret edhe alkooli i destiluar natyral (i fituar me prejardhje tjetër natyrale) me vendosjen e produkteve të ndryshme bimore ose të tjera, ku nëpërmjet, përzierjes, amortizimit, ngjyrosjes, stazhionim e kështu me radhë, fitohen pije të ndryshme alkoolike ku përmbajtja e etil alkoolit shpesh është më shumë se 15% ndërsa në to mund të përfshihen lloje të ndryshme të likereve, koktejeve, etj).
- prodhim dhe tregti me armë dhe municion të çfarëdo lloji;
- kazino dhe persona të tjerë juridik për organizimin e lojërave të fatit dhe lojëra të tjera argëtuese;
- hulumtim, zhvillim dhe kërkesa teknike që kanë të bëjnë me të dhënat elektronike, programe ose zgjidhje që kanë të bëjnë me:
 - a) mbështetjen e çfarëdo aktivitetit që përfshihet në sektorët e sipërpërmendur nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni;
 - b) bixhoz në internet dhe kazino online dhe/ose
 - c) pornografi;
- hulumtime natyrore- shkencore, zhvillimi ose aplikacione teknike që kanë të bëjnë me klonimin njerëzorë për qëllime hulumtuese ose terapeutike; dhe/ose për organizma të modifikuar gjenetikisht (OMG).
- prodhimi i qymyrit.

(5) Bashkëpunimi mes sektorin privat dhe institucioneve të arsimit të lartë përkatësisht institucionet shkencore- hulumtuese ose forma të tjera të bashkëpunimit për komercializimin e inovacioneve do të konsiderohet si përparësi në propozimprojektin.

Kohëzgjatja e projektit

Neni 6

- (1) Kohëzgjatja e projektit për të cilin janë ndarë mjete financiare nëpërmjet këtij instrumenti mund të jetë deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj.
- (2) Shfrytëzuesi në bazë të shkaqeve të arsyeshme mund të kërkoj vazhdimin e kohëzgjatjes së projektit, duke dorëzuar kërkesë me shkrim ku do të evidentohen shkaqet e vazhdimit. Kërkesa dorëzohet para përfundimit të kohëzgjatjes së projektit.
- (3) Në bazë të kërkesës së dorëzuar sipas paragrafit (2), Fondi mund të miratojë vazhdimin e zbatimit të projektit deri në 2 (dy) muaj.
- (4) Vazhdimi i zbatimit të projektit më gjatë se periudha sipas paragrafit (3) të këtij neni mund të miratohet vetëm me vendim të Komitetit për miratimin e investimeve.
- (5) Nën rrethana të zakonshme, kohëzgjatja e zbatimit të projektit mund të vazhdohet maksimum për 6 (gjashtë) muaj shtesë, pas miratimit paraprak të pëlqimit sipas paragrafit (4) të këtij neni.
- (6) Nëse Fondi, përkatësisht Komiteti merr vendim për vazhdimin e kohëzgjatjes së projektit, vazhdimi i kohëzgjatjes fillon nga dita e marrjes së vendimit për vazhdim. Në periudhën nga përfundimi i kohëzgjatjes së projektit deri në ditën e marrjes së vendimit për vazhdim nga Fondi përkatësisht Komiteti, shfrytëzuesit nuk do t'i pranohet kurrfarë shpenzimi dhe aktiviteti, dhe ai obligohet ose të përmbahet nga shpenzimet dhe aktivitetet ose vetë t'i bartë shpenzimet e bëra.
- (7) Në rast të vazhdimit të kohëzgjatjes së zbatimit të projektit, vlera e grantit të ndarë nuk mund të rritet.

Kriteret e përshtatshmërisë së aplikuesit

Neni 7

- (1) Kriteret e përshtatshmërisë që aplikuesi duhet t'i plotësojë janë:
 - të jetë shoqëri tregtare e themeluar sipas Ligjit të Shoqërive Tregtare dhe e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose ekip që përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, persona fizikë;
- (2) Në rastin kur si aplikues paraqitet një shoqëri tregtare, ai duhet t'i plotësojë këto kritere të përshtatshmërisë:
 - të ardhurat vjetore të aplikuesit të mos kalojnë 1.000.000 (një milion) euro në kundërvlerë denari, sipas raporteve financiare për dy vitet paraprake fiskale;
 - numri mesatar i punonjësve të mos e kalojë numrin prej 250;
 - nga momenti i regjistrimit të shoqërisë tregtare deri në momentin e dorëzimit të propozimprojektit në Fond të mos kenë kaluar më shumë se 6 (gjashtë) vite;
 - shoqëria tregtare të jetë në pronësi të personit fizik dhe/ose juridik (që nuk është në pronësi shtetërore), shoqatë ose fondacion dhe/ose institucion që kryen veprimtari të arsimit të lartë përkatësisht veprimtari shkencore- hulumtuese (me pjesëmarrje pronësore të aplikuesit deri 20%).
 - aplikuesi ose aksionarët e tij të mos jenë indirekt ose drejtpërdrejtë pronarë të mbi 20% në shoqëri tjetër tregtare, të dhënat vjetore të së cilës tejkalojnë 1.000.000 (një milion) euro në kundërvlerë denari në dy vitet paraprake fiskale dhe numri

mesatar i punonjësve nuk e tejkalon numrin prej 250 punëtorëve, përveç në rast të lidhjes me institucion të arsimit të lartë, përkatësisht institucion shkencor-hulumtues;

- kundër tij të mos ketë procedurë falimentimi ose procedurë likuidimi;
- të ketë detyrime të shlyera lidhur me shpenzimet publike dhe kontribute;
- kundër tij të mos ketë procedura të filluara për realizim të detyrueshëm të kërkesave të arritura financiare;
- Në pajtim me Ligjin e Kontrollit të Ndhmës Shtetërore dhe Dispozitën për kushtet dhe procedurën e ndarjes së ndihmës me domethënie të vogël (de minimis), t'i përmbush këto kushte:
 - të mos ketë akumuluar më shumë se 200.000 (dyqind mijë) euro ndihmë me domethënie të vogël, për periudhën prej tre viteve fiskale, përfshirë edhe vlerën e kërkuar të mjeteve nga Fondi;
 - të mos ketë akumuluar më shumë se 100.000 (njëqind mijë) euro ndihmë me domethënie të vogël për periudhë prej tre viteve fiskale, duke përfshirë edhe vlerën e kërkuar të mjeteve nga Fondi, nëse ndërmarrja është aktive në sektorin e trafikut rrugor;
 - të mos ketë vështirësi (ndërmarrje me vështirësi është ndërmarrja që nuk ka mundësi t'i plotësojë obligimet e veta nga burimet personale ose me mjete që mund t'i marrë nga pronari i tij, aksionarët ose kreditorët, që t'i ndalojë humbjet, që pa intervenim të jashtëm nga ofruesit e ndihmës mund të çojë deri në ndërprerje afatshkurtër dhe afatgjatë të punës së ndërmarrjes) dhe
 - të mos merret me prodhimin e qymyrit.

(3) Në rastet kur si aplikues paraqitet ekipi ndërsa propozimprojekti e ka kaluar fazën e selektimit, aplikuesi obligohet në afat prej 30 ditëve kalendarik pas pranimit të njoftimit për selektimin e propozimprojektit, të themelojë shoqëri tregtare ku si themelues do të paraqiten të paktën 51% nga anëtarët e ekipit, që shoqëria tregtare do t'i marrë të gjitha të drejtat dhe obligimet lidhur me zbatimin e projektit dhe që do t'i plotësojë kriteret e përshtatshmërisë nga ky nene.

Neni 8

(1) Mjetet e marra nga Fondi duhet të destinohen për aktivitete zhvillimore dhe për zbatimin e inovacioneve të propozuara.

(2) Aktivitete të pranueshme për financim janë:

- aktivitetet për hulumtim dhe zhvillim;
- zhvillimi i pilot-linjave të prodhimeve dhe/ose shërbimeve;
- aktivitete për testim dhe validacion të prodhimeve, shërbimeve dhe proceseve të reja ose të avancuara;
- aktivitete për testimin e tregut dhe validacionit të shfrytëzuesve potencial;
- aktivitete lidhur me mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe
- dizajni.

(3) Të gjitha aktivitetet që janë të përshtatshme për zbatim në suazat e projektit mund të përfshijnë demonstrimin e teknologjisë, krijimin e prototipit, pilotim, testim dhe

validacion të produkteve të reja ose të avancuara, procese ose shërbime ku qëllimi kryesor është të arrihet avancim i dukshëm. Epilogu më i vogël i pritur nga projektet që financohen nëpërmjet këtij instrumenti është krijimi i një prototipi të përdorshëm komercial ose pilot pas përfundimit të fazës së zhvillimit në suazat e projektit. Në rast aplikuesi të ketë prototip tashmë të zhvilluar në momentin e aplikimit, pritet deri në fund të realizimit të projektit të zhvillojë produkt ose shërbim përfundimtar.

(4) Fondi nuk inkurajon propozimprojekte të fokusuara për ndryshime rutinore ose periodike të produkteve tashmë ekzistuese, linja prodhuese, procese prodhuese, shërbime aktivitete të tjera tashmë të vendosura (për shembull: përditësim të versioneve të softuerit ose ridizajn të produktit, etj) që nuk rezultojnë në vlerë reale dhe pronësi intelektuale ose know-how, edhe pse këto ndryshime mund të paraqesin avancim të rëndësishëm në punën e aplikuesit.

Shpenzime të përshtatshme për financim

Neni 9

(1) Shpenzimet e pranueshme për financimin e këtij instrumenti janë:

- rrogat bruto me shtesa të përfshira të rrogës, të përkufizuara në pajtim me Ligjin e Marrëdhënieve të Punës (punë për ftesë, punë ditën e diel, punë në turne, punë nate, etj) për personat që janë ose do të punësohen të shfrytëzuesi dhe drejtpërdrejtë marrin pjesë në realizimin e projektit. Vlerat e rrogave bruto për personat e punësuar, të angazhuar në projekt, duhet të përshtaten me praktikatat e vendosura të shfrytëzuesit para fillimit të projektit, të ulura për vlerën e subvencionit potencial shtetëror, e marrë në bazë të rrogës;
- prokurimi dhe/ose huazimi i pajisjes dhe materialit shpenzues për hulumtim dhe zhvillim;
- shërbimet nënkontraktuese për hulumtim dhe zhvillim (për shembull, testim, shërbime laboratorike, etj);
- angazhimi i ekspertëve/ këshilltarëve për hulumtim dhe zhvillim;
- angazhimi i konsulentëve për nevoja që drejtpërdrejtë lidhen me rezultatet e projektit (ekspertizë për menaxhim të inovacionit, menaxhim financiar, mobilizim të mjeteve, zhvillim të biznesit, ekspertizë marketingu për testimin e tregut dhe validacioni i shfrytëzuesve potencial, punë juridike, mbrojtja e pronësisë intelektual, etj);
- përgatitja dhe dorëzimi i paraqitjes për patentë, mbrojtja e markës tregtare dhe/ose dizajni industrial dhe
- mbështetja afariste dhe e zyrës (huazim i hapësirës afariste, shpenzime mujore, provizionet bankare, shërbime kontabiliteti, hosting dhe lloje të tjera të shpenzimeve operative lidhur me realizimin e projektit) në vlerë maksimale prej 15% nga buxheti i përgjithshëm i projektit.

(2) Vetëm shpenzimet për aktivitetet e zbatuara në kohëzgjatjen e projektit, që janë në pajtim me buxhetin e miratuar të projektit dhe rregullat e procedurat e Fondit janë të përshtatshme për financim.

(3) Shpenzimet e papranueshme për financimin e këtij instrumenti janë:

- shpenzime për furnizim me të mira, shërbime dhe gjëra nga ndërmarrjet publike vendore, përveç shpenzimeve mujore;
- shpenzime për norma interesi ose borxh të ndonjë pale tjetër;
- shpenzime dhe rezervime humbje ose boxhe për humbje të kaluara ose të ardhura;
- mbulimi i humbjeve për shkak të këmbimit të valutës, taksës ose gjobës;
- shpenzime për ushqim dhe gastronomi;
- shpenzime për rekrutimin e kuadrit (shpenzime për publikimin e shpalljes, provizione nga agjencitë e punësimit, shpenzime për selektim të kandidatëve, etj) dhe shpenzime për shpërngulje;
- blerje të tokës ose ndërtesave, përfshirë edhe rinovimin;
- pagesë me të holla në dorë nga llogaria e projektit;
- aktivitete eksporti (shpenzime që drejtpërdrejtë lidhen me eksportin e produkteve, me themelin dhe punim të rjetit shpërndarës ose për shpenzime të tjera aktuale të aplikuesit lidhur me aktivitetet eksportuese);
- taksa vjetore për mirëmbajtjen e patentës (me përjashtim të rasteve të arsyetueshme, të vlerësuara si shpenzim i lejuar gjatë vlerësimit të propozimprojekteve);
- shtesë të rrogave në formë regresi për pushim vjetor, rroga e trembëdhjetë, sukses në punë, etj;
- shpenzime për shërbime konsulenti, të siguruar nga pronari/ët e shfrytëzuesit si dhe personat e autorizuar nga shfrytëzuesi (drejtues/drejtor);
- shpenzime për shërbime konsulenti të siguruar nga persona të punësuar te shfrytëzuesi;
- qiramarrje të hapësirës afariste nga qiradhënësi që merr pjesë në aktivitetet e projektit ose është person i lidhur me shfrytëzuesin;
- furnizim të automjeteve ngarkuese transportuese nga ndërmarrje që kryejnë transport ngarkues transportues për qiramarrje ose kompensim;
- furnizim të automobilave (me përjashtim të rasteve të arsyetueshme, të vlerësuara si shpenzim i lejuar gjatë vlerësimit të propozimprojekteve);
- shpenzime për furnizim të pajisjes së dorës së dytë;
- tatim të vlerës së shtuar (TVSH) për të gjitha furnizimet sipas paragrafit 1 të këtij neni;
- shpenzime për marketing të drejtpërdrejtë dhe
- shpenzomë për realizimin e aktiviteteve që paraprakisht kanë qenë të financuara nga burime të tjera.

(4) Lista e shpenzimeve sipas paragrafit 3 të këtij neni nuk është përfundimtare.

II. PROCESI I APLIKIMIT

Konkursi publik

Neni 10

- (1) Mjetet financiare sipas këtij instrumenti jepen në bazë konkurruese pas shpalljes së konkursit publik.
- (2) Fondi shpall konkurs publik me procedurë të rregullt dhe konkurs publik me procedurë të shkurtuar.
- (3) Konkursi publik publikohet në të paktën dy media publike dhe në faqen e internetit të Fondit.
- (4) Afati për dorëzimin e projektpropozimeve do të përcaktohet deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga shpallja e konkursit publik nga Fondi dhe mund të vazhdohet për shkak të rrethanave të arsyeshme.
- (5) Buxheti i përgjithshëm i çdo tenderi publik përcaktohet nga Fondi në pajtim me Programin vjetor të punës së Fondit dhe/ose me Programin afatmesëm të punës të Fondit.

Përmbajtja e konkursit publik

Neni 11

- (1) Konkursi publik detyrimisht i përmban këto informacione:
 - të dhënat për organin që e shpall thirrjen;
 - datën e shpalljes së konkursit publik;
 - mënyrën e dorëzimit të propozimprojektit dhe dokumentacionin shoqërues;
 - afatin e fundit për dorëzimin e propozimprojektit;
 - përshkrim të shkurtër të instrumentit, përfshirë kriteret e përshtatshmërisë së aplikuesit, aktivitetet dhe shpenzimet që janë dhe nuk janë të pranueshme për financim;
 - buxhetin e përgjithshëm të konkursit;
 - informacione kontakti dhe
 - të dhëna të tjera të nevojshme për realizimin e thirrjes publike.
- (2) Të gjitha të dhënat e sipërmendura duhet të figurojnë në tërë konkursin publik, të publikuar në faqen e interneti të Fondit.
- (3) Për konkursin publik të publikuar në gazetatat publike, përgatitet version i shkurtuar.

Aplikimi në procedurë të rregullt

Neni 12

- (1) Gjatë aplikimit për marrjen e mjeteve financiare nëpërmjet këtij Instrumenti të Fondi, detyrimisht duhet të dorëzohen këto dokumente:
 1. Dokumentacioni i projektit (i cili përfshin formularët e propozimprojektit, i arritëm nëpërmjet faqes së internetit të Fondit) që përbëhet nga:
 - formulari i plotësuar me rregull për aplikacion të projektit
 - formulari i plotësuar me rregull për buxhetin e projektit
 - deklaratë të aplikuesit për pranimin e kushteve të Fondit
 - pyetësor të plotësuar me rregull për mjedisin jetësorë dhe

- deklaratë e verifikuar në noter për strukturën pronësore- themeluese të aplikuesit (përveç në rast kur si aplikues paraqitet ndonjë ekip, atëherë ajo dorëzohet pas themelimit të shoqërisë tregtare).

2. Dokumentacionin që e siguron aplikuesi:

- biografi të shkurtra të personave që e përbëjnë ekipin, të angazhuar në projekt (të paktën për 5 (pesë) persona);

(2) Aplikacioni për projektin, buxheti i projektit dhe biografitë duhet të dorëzohen në gjuhën maqedonase dhe angleze.

(3) Pjesa tjetër e dokumentacionit lidhur me aplikuesit duhet të dorëzohet vetëm në gjuhën maqedonase.

(4) Dokumentacioni i projektit detyrimisht dorëzohet me formularët e përgatitur nga Fondi.

(5) Në rast se projekti bazohet në të drejtat tashmë ekzistuese të pronësisë intelektuale, aplikuesi është i detyruar të paraqesë, së bashku me dokumentacionin e projektit, dëshminë e së drejtës për shfrytëzimin e pronës intelektuale në formë të marrëveshjes për licencim, marrëveshje për kontribut jomonetar ose lloj tjetër të marrëveshjes që vërteton se aplikuesi ka të drejtë të përdorë pronësinë intelektuale në të cilën bazohen rezultatet e projektit.

(6) Aplikuesi nuk duhet t'i shkelë me vetëdije ose qëllimisht të drejtat e pronësisë intelektuale të ndonjë pale të tretë.

(7) Të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale dhe "know how" që do të krijohen gjatë zbatimit të projektit dhe/ose si rezultat i zbatimit të projektit i përkasin shfrytëzuesit, dhe nëse është e zbatueshme, shfrytëzuesi duhet t'i mbrojë të drejtat e pronësisë intelektuale .

(8) Me përjashtim sipas paragrafit (7) të këtij neni, në rast të propozimprojektit që përfshin kontratë bashkëpunimi me institucionin e arsimit të lartë dhe/ose institucionin shkencor-hulumtues, të drejtat e pronësisë intelektuale në lidhje me projektin duhet të rregullohen qartë në kontratën e bashkëpunimit.

(9) Fondi nuk do të jetë përgjegjës për kontestet në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale ndërmjet aplikuesit/shfrytëzuesit të mbështetjes financiare dhe palëve të treta.

(10) Çdo propozimprojekt i paraqitur në konkurs publik për ndarjen e mjeteve për Fondin duhet të jetë në pajtim me dispozitat në fuqi për mbrojtjen e mjedisit jetësorë dhe uljen e ndotjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(11) Fondi e ka të drejtën, nëse është e nevojshme, të kërkojë dokumentacion tjetër nga aplikuesi.

Aplikimi me procedurë të shkurtuar

Neni 13

(1) Në konkurs publik me procedurë të shkurtuar për marrjen e mjeteve nga Fondi, kanë të drejtë të aplikojnë aplikues propozimprojekti i të cilëve nuk është miratuar nga Komiteti

ndërsa e ka kaluar fazën e para- selektimit në 12 muajt paraprak nga momenti i shpalljes së konkursit.

(2) Aplikuesit sipas paragrafit (1) të këtij neni, gjatë aplikimit për marrjen e mjeteve financiare me procedurë të shkurtuar nëpërmjet këtij Instrumenti të Fondit, duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- aplikacionin e projektit;
- buxhetin e projektit;
- biografi të shkurtra (maksimum deri 5 (pesë) persona) për anëtarët e ekipit dhe
- deklaratë se nuk ka ndryshim në dokumentacionin e detyrueshëm, që ndikon në përshtatshmërinë e aplikuesit, e dorëzuar në thirrjen/konkursin paraprak në të cilin kanë aplikuar dhe se i plotësojnë kushtet e përshtatshmërisë së konkursit në të cilin aplikojnë.

(3) Dokumentacionin që e dorëzojnë aplikuesit sipas këtij neni, duhet t'i plotësojnë kushtet e parapara në nenin 12, paragrafët (2), (3), (4), (5), (6), (7), (8), (9) dhe (10) të kësaj rregulloreje.

(4) Propozimprojektet me të cilat aplikohet me procedurë të shkurtër nuk do ta kalojnë përsëri fazën e paraselektimit, por ato do të vlerësohen nga Komiteti në fazën e selektimit dhe do të shqyrtohen në fazën e kontrollit administrativ nga aspekti i plotësimit të kushteve për përshtatshmëri.

(5) Gjatë dorëzimit të propozimprojekteve, Fondi e dorëzon pranë Komitetit aplikacionin e projektit, buxhetin e projektit dhe biografi të shkurtra të anëtarëve të ekipit, përshkrim ose informacion për aplikuesin përkatësisht shfrytëzuesin si dhe dokumentacion tjetër me ndikim për marrjen e vendimit përfundimtar.

Dokumentacioni shtesë

Neni 14

(1) Në rast se aplikuesi zgjidhet për financim nëpërmjet këtij Instrumenti, para marrjes së vendimit përfundimtar financiar dhe/ose para nënshkrimit të kontratës për ndarjen e fondeve, aplikuesi në Fond duhet të dorëzojë edhe:

- kontrata me palë të treta të rëndësishme për zbatimin e projektit (përfshirë kontratat për punonjësit);
- deklaratë për ndihmë shtetërore të marrë paraprakisht;
- njoftim të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut nëse aplikuesi dhe themeluesi/t e tij janë themelues në persona të tjerë juridikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- plan të nënshkruar dhe të shtypur për menaxhimin e mjedisit jetësor (nëse është e aplikueshme përkatësisht nëse propozimprojekti është i kategorizuar si rrezik mesatar nga eksperti i mjedisit mjedisorë);
- informacion për llogari të hapur e dedikuar për projektin dhe
- dokumentacion shtesë që vërteton përmbushjen e kërkesave të përshtatshmërisë së aplikantit.

(2) Aplikuesi duhet të dorëzojë dokumentet shtesë brenda 5 ditëve të punës, nga data e njoftimit nga Fondi.

(3) Fondi e mban të drejtën, nëse është e nevojshme, të kërkojë dokumentacion tjetër nga aplikuesi, i cili është i obliguar ta dorëzojë në kohën më të shkurtër të mundshme, ose nëse është e mundur, Fondi mund ta sigurojë vetë dokumentacionin, dhe në rast të tillë, në pajtim me dokumentacionin shtesë, Fondi mund t'ia kthejë Komitetit gjithë propozimprojektin për shqyrtim dhe vendimmarrje.

III. VLERËSIMI

Kriteret e vlerësimit të propozimprojekteve

Neni 15

(1) Kriteret themelore për vlerësimin e projekteve dhe ndarjen e mjeteve sipas këtij instrumenti janë:

- shkalla e inovacionit;
- cilësia e projektit;
- kapaciteti i ekipit të projektit;
- potenciali i tregut dhe
- ndikimi

(2) Kriteret dhe nënkriteret themelore për vlerësimin e projekteve gjenden në formularin e tabelës së vlerësimit.

Neni 16

(1) Të gjitha propozimprojektet që dorëzohen në kohë, Fondi ua dërgon personave profesionistë për zbatimin e fazës së paraselektimit

(2) Fondi gjatë marrjes së dokumenteve vërteton nëse deklaratat nga neni 12 dhe/ose neni 13 nga kjo rregullore, janë të nënshkruara dhe shtypura me rregull, e nëse jo, dërgohet njoftim deri te aplikuesi për korrigjimin e tyre në afat prej 2 ditëve të punës nga njoftimi.

(3) Nëse deklaratat, sipas paragrafit 2 të këtij neni të rregullores nuk janë të korrigjuara në mënyrë përkatëse përkatësisht nuk janë të kompletuara në afatin sipas paragrafit 2 të këtij neni, aplikacioni/et nuk do të shqyrtohet/n nga personat profesionistë dhe/ose nga Komiteti. Nëse ka shkaqe të arsyetueshme, për të cilat aplikuesi nuk mund t'i kryejë korrigjimet e kërkuara ose t'i kompletojë deklaratat në afatin e paraparë, duhet menjëherë ta informojë Fondin dhe ta arsyetojë atë.

(4) Për të gjithë propozimprojektet, Fondi përgatit tabelë, e cila, mes të tjerash, i përmban këto të dhëna:

- emrin e aplikuesit;
- strukturën pronësore të aplikuesit dhe
- personin e autorizuar (drejtuesin/drejtorin) nga aplikuesi.

(5) Tabela sipas paragrafit (4) të këtij neni, dorëzohet deri te punonjësit e Fondit, drejtori i Fondit, anëtarët e Këshillit Drejtues të Fondit, personat profesionalë dhe anëtarët e Komitetit për miratimin e investimeve, për vërtetimin e konfliktit të mundshëm të interesave sipas Ligjit të Parandalimit dhe Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave.

(6) Tabela sipas paragrafit (4) të këtij neni, dorëzohet edhe deri te persona të tjerë, të përfshirë drejtpërdrejtë në proces, për vërtetimin e konfliktit të mundshëm të interesave sipas Ligjit të Parandalimit dhe Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave.

(7) Në rast se dikush nga personat profesionalë identifikon konflikt të interesave, ai obligohet ta informojë Fondin në afat sa më të shkurtër kohor. Fondi do ta përjashtojë këtë person nga procesi i vlerësimit (nga faza e para- selektimit) të propozimprojektit dhe do të emërtojë person tjetër profesional përkatës në vendin e tij.

(8) Në rast se dikush nga anëtarët e Komitetit identifikon konflikt të interesave, ai obligohet ta informojë Fondin në afat sa më të shkurtër kohor. Fondi do ta përjashtojë këtë person nga procesi i vlerësimit (nga faza e selektimit) të propozimprojektit.

(9) Në rast më shumë anëtarë të Komitetit identifikojnë konflikt të interesave lidhur me ndonjë propozimprojekt dhe ky projekt të mos mund të vlerësohet nga të paktën 3 (tre) anëtarë të Komitetit, projekti do të përjashtohet nga procedura dhe nuk do të vlerësohet.

Procesi i vlerësimit

Neni 17

(1) Vlerësimi i propozimprojekteve zhvillohet në dy faza: faza e para- selektimit dhe faza e selektimit.

(2) Fazën e para- selektimit e zbatojnë personal profesionalë. Çdo propozimprojekt do të vlerësohet në këtë fazë nga dy persona profesionalë nga fushat që përputhen me kriteret e vlerësimit përkatësisht me qëllimet e Instrumentit dhe një person nga fusha që përputhet me propozimprojektin, përveç nëse bëhet fjalë për propozimprojekt në pajtim me nenin 13 të kësaj rregullore, atëherë ky propozimprojekt nuk do ta kalojë fazën e para- selektimit.

(3) Faza e selektimit realizohet nga Komiteti i miratimit të investimeve, që e merr vendimin përfundimtar për financim nëpërmjet këtij Instrumenti.

(4) Në fazën e selektimit duhet të marrin pjesë të paktën tre nga anëtarët e Komitetit.

Faza e paraselektimit

Neni 18

(1) Në fazën e para- selektimit, ekspertët e caktuar nga Fondi kanë obligim të plotësojnë tabelën e vlerësimit për secilin nga propozimprojektet dhe të japin mendim profesional dhe vlerësim për propozimprojektet në afat prej 7 (shtatë) ditësh pune nga dita e marrjes së propozimprojektit.

(2) Në fazën e para- selektimit, personat profesionalë kanë të drejtë të bëjnë pyetje shtesë për aplikuesit dhe propozimprojektet, të cilat do të kontrollohen nga punonjësit e Fondit. Drejtori i Fondit emëron persona të cilët i sigurojnë informacionet e nevojshme shtesë nëpërmjet vizitave në terren të aplikuesit, komunikimit me personat kyç të propozimprojektit dhe/ose verifikimit administrativ të informacioneve. Personat e emëruar janë të obliguar të japin informacionin e nevojshëm brenda një afati të përcaktuar paraprakisht nga drejtori i Fondit.

(3) Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara për çdo propozimprojekt përcaktohet si mesatare e notave të marra nga personat profesional të caktuar për të vlerësuar atë propozimprojekt në fazën e para- selektimit.

(4) Çdo propozimprojekt që ka marrë 51 (pesëdhjetë e një) pikë ose më shumë (nga gjithsej 100 (njëqind) pikë) në fazën e para-selektimit, kalon në fazën tjetër të selektimit.

(5) Çdo propozimprojekt që ka marrë më pak se 51 (pesëdhjetë e një) pikë (nga gjithsej 100 (njëqind) pikë) në fazën e paraselektimit, refuzohet për financim sipas këtij Instrumenti për mbështetjen e Fondit.

(6) Çdo aplikues, propozimprojekti i të cilit nuk ka marrë të paktën 51 (pesëdhjetë e një) pikë, përkatësisht, projekti i të cilit nuk ka kaluar në fazën e selektimit, do të njoftohet për rezultatet në kohë.

(7) Në rastin e aplikuesit, i cili i plotëson kriteret e përshtatshmërisë në pajtim me nenin 7 të kësaj rregullore dhe ka aplikuar për konkurs publik me procedurë të shkurtuar, në pajtim me nenin 13 të kësaj rregullore, propozimprojekti i tillë nuk do ta kalojë fazën e paraselektimit.

Faza e selektimit

Neni 19

(1) Në fazën e para- selektimit, çdo anëtar i Komitetit bën vlerësim të propozimprojekteve që e kanë kaluar fazën e para- selektimit përkatësisht të propozimprojekteve nga konkursi publik me procedurë të shkurtër dhe obligohet ta plotësojë tabelën e vlerësimit për çdo propozimprojekt dhe t'i vlerësojë ata në afatin e paraparë nga Fondi.

2) Anëtarët e Komitetit kanë të drejtë në fazën e selektimit të parashtrajnë pyetje shtesë për aplikuesit dhe propozimprojektet, që do të kontrollohen nga Fondi. Drejtori zgjedh persona që do t'i sigurojnë informacionet e nevojshme shtesë, me vizita në terren të aplikuesit, me komunikim të personave kyç të propozimprojektit dhe/ose kontrollit administrativ të informacioneve. Personat e zgjedhur obligohet informacionet e nevojshme t'i sigurojnë në afatin e paraparë nga Fondi.

(3)

Fondi mund të organizojë prezantim të propozimprojekteve në fazën e selektimit. Në këtë prezantim, secili aplikues do të prezantojë shkurtimisht propozimprojektin e tij kurse anëtarët e Komitetit kanë të drejtë të bëjnë pyetje për të marrë informacione shtesë që do t'i ndihmojë në marrjen e vendimit.

(4) Nëse gjatë fazës së selektimit, Komisionit gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të propozimprojekteve i nevojitet mendim profesional nga një fushë e caktuar, atë mund ta marrë nga personat profesional, në pajtim me procedurën e përcaktuar me rregullore për mënyrën e përfshirjes dhe punës së profesionistëve në punën e Fondit të Inovacionit dhe Zhvillim Teknologjik dhe dhënien e mendimit profesional.

(5) Gjatë fazës së selektimit, Fondi mund të angazhojë persona të tjerë si vëzhgues.

(6) Në fazën e selektimit, propozimprojekteve e para-selektuar shqyrtohen gjithashtu nga ekspert(ë) të mjedisit jetësorë. Eksperti i mjedisit jetësorë është i obliguar t'i kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për vlerësimin e propozimprojekteve të para-selektuara në pajtim me dokumentin "Korniza e Mbrojtjes së Mjedisit Jetësorë". Eksperti i mjedisit jetësorë është i obliguar të paraqesë para Fondit raport për kategorizimin e propozimprojekteve të para-selektuara. Sipas Kornizës së Menaxhimit me Mjedisin Jetësorë, Fondi nuk do të financojë projekte të kategorizuara nën "kategorinë 3 - rrezik i lartë".

(7) Vlerësimet dhe mendimet profesionale të marra nga personat profesionalë, historinë e aplikuesve përkatësisht shfrytëzuesve dhe raportet për informacionet e siguruar shtesë nga Fondi, u dorëzohen të gjithë anëtarëve të komitetit, të cilët obligohen ato t'i marrin parasysh gjatë vlerësimit të propozimprojekteve.

(8) Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara për çdo propozimprojekt të selektuar vërtetohet si mesatare nga vlerësimet e personave profesionalë, të marra në fazën e para-selektimit dhe nga çdo anëtar i Komitetit të marra në fazën e selektimit.

(9) Në bazë të pikëve të fituara, përpunohet renditja indikative e propozimprojekteve të selektuara.

(10) Komiteti përpilon listë të propozimprojekteve që janë përzgjedhur për financim dhe për të cilat do të merret vendim përfundimtar për financim, nëse Komisionit i Kontrollit Administrativ vërteton se i plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në rregullore dhe/ose nëse buxheti i projektit korrigjohet sipas kërkesave të Komisionit të Kontrollit Administrativ.

(11) Nëse gjatë procedurës administrative vërtetohet se disa nga aplikuesit nuk i plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë dhe/ose nuk i kanë bërë korrigjimet e kërkuar sipas nenit 20 neni 7 të kësaj rregullore, Komiteti në mënyrë përkatëse e revidon listën e propozimprojekteve që do të përzgjidhen për financim.

Neni 20

- (1) Me qëllim që të vërtetohet nëse aplikuesi i plotëson kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në konkursin publik dhe në këtë rregullore, në bazë të dokumentacionit nga neni 12 i kësaj rregullore dhe shqyrtimit të buxheteve të dorëzuara, formohet komision (ose komisione) për kontroll administrativ të propozimprojekteve të përzgjedhura për financim. Komisioni (ose komisionet) e/i shqyrtojnë çdo aplikues dhe bushet veçmas.
- (2) Komisionin e kontrollit administrativ e formon drejtori i Fondit ose person i autorizuar nga drejtori i Fondit ndërsa përbëhet prej të paktën tre punonjës të angazhuar në Fond.
- (3) Gjatë kontrollit të aplikuesve dhe buxheteve, Komisioni i kontrollit administrativ udhëhiqet sipas dokumentit për kontroll administrativ të propozimprojekteve.
- (4) Nëse Komisioni i kontrollit administrativ gjatë shqyrtimit të propozimprojekteve ka nevojë për mendim profesional nga fusha përkatëse, mendimi profesional sigurohet nga ekspertët nga fusha përkatëse dhe/ose nga institucionet relevante.
- (5) Pas përfundimit të kontrollit administrativ të propozimprojekteve, Komisioni i kontrollit administrativ përgatit procesverbal dhe atë ia dorëzon Komitetit.
- (6) Nëse ndonjë aplikues nuk e ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar ose e ka plotësuar buxhetin në mënyrën jo të duhur për projektin, Komisioni i kontrollit administrativ, në mënyrë elektronike e informon aplikuesin dhe i jep mundësi në afat prej 5 (pesë) ditëve të punës, në mënyrë shtesë t'ia dorëzojë në mënyrë elektronike ose në arkivin e Fondit dokumentet që mungojnë dhe/ose të dorëzojë buxhet të korrigjuar të projektit dhe/ose dokumentacionit e mbetur shtesë. Nëse gjatë dorëzimit shtesë të dokumenteve, nuk lejohen ndryshime në aplikacionin e projektit ose në buxhetin e projektit që nuk kërkohen nga Fondi.
- (7) Nëse aplikuesi nuk i dorëzon dokumentet që mungojnë as në 5 (pesë) ditët shtesë të punës, nuk e korrigjon buxhetin ose aplikuesi nuk i plotëson kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në këtë rregullore, Komisioni i kontrollit administrativ vendos vërejtje në procesverbal se për atë aplikues përkatësisht propozimprojekt nuk janë plotësuar kushtet që të merret vendimi përfundimtar për financim.
- (8) Procesverbali sipas paragrafit (5) të këtij neni, së bashku me dokumentet e plotësuara për kontroll administrativ të propozimprojekteve, përgatitet nga Komisioni i kontrollit administrativ.

Vendimi për financim

Neni 21

- (1) Vendimin përfundimtar për financimin e propozimprojektit nga ky Instrument e merr Komiteti në takimin e mbajtur në afat prej të paktën 90 (nëntëdhjetë) ditë nga dorëzimi i propozimprojekteve në Komitet.
- (2) Vendimin përfundimtar për financim Komiteti e merr gjatë takimit me votim publik “PËR” ose “KUNDËR” ndarjes së mjeteve për propozimprojekt të caktuar. Mjetet për propozimprojekt të caktuar në fazën e selektimit mund të ndahen vetëm nëse të paktën tre anëtarë të Komitetit votojnë “PËR” ndarjen e mjeteve për atë propozimprojekt të caktuar.
- (3) Gjatë marrjes së vendimit për financim, ndikim ka edhe buxheti në dispozicion për financim gjatë çdo konkursi publik. Komiteti mund të marrë vendim për financim të propozimprojekteve në suazat e buxhetit të vërtetuar paraprakisht për konkursin publik ose nëse ai buxhet rritet për konkursin konkret.
- (4) Nëse Komisioni merr vendim që është në kundërshtim me vlerësimin dhe mendimin e personave profesionalë, ai duhet të përmbajë shpjegim të hollësishëm të arsyeve për marrjen e vendimit të tillë.
- (5) Nëse për këtë instrument nuk ka mjaftueshëm propozimprojekte të miratuara për financim të paraqitura në tender publik, mjetet e pashfrytëzuara nga buxheti në tenderin publik mund të përdoren për tender tjetër publik për këtë instrument ose mjete në vlerë prej 30% të buxhetit të thirrjes publike mund të ridestinohen nga një tender publik në tjetrin për instrument tjetër të Fondit nëse për atë instrument ka disa propozimprojekte të përshtatshme për financim.
- (6) Bashkimi i komenteve për propozimprojektet që janë refuzuar për financim në fazën e selektimit, bëhet nga një anëtar i Komisionit, i emëruar nga Fondi, i cili ka vlerësuar propozimprojektet.
- (7) Gjatë marrjes së vendimit përfundimtar për financim, Komisioni do të marrë parasysh edhe procesverbalin e komisionit(ve) për kontroll administrativ.
- (8) Nëse ekipi nuk themelon shoqëri tregtare brenda afatit të caktuar prej 30 ditëve, Komiteti merr vendim për refuzimin e propozimprojektit.
- (9) Çdo aplikues propozimprojekti i të cilit ka kaluar fazën e selektimit dhe kontrollin administrativ do të njoftohet për rezultatet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e vendimit përfundimtar për financim nga Komisioni.
- (10) Në rast se projektet e njëjta ose të ngjashme të propozuara paraqiten në të njëjtin konkurs publik, Komisioni do t'i shqyrtojë përsëri dhe do të marrë vendimin e duhur.
- (11) Aplikuesit, propozimprojektet të të cilëve nuk do të miratohen për financim, mund të aplikojnë përsëri për mjete nga Fondi deri në tri herë me të njëjtin propozimprojekt.

IV. NDARJA E MJETEVE

Lidhja e kontratës për ndarjen e mjeteve Neni 22

- (1) Aplikuesit për të cilët është marrë vendim për financim, nënshkruajnë Kontratë për ndarjen e mjeteve.
- (2) Para nënshkrimit të Kontratës për ndarjen e mjeteve nëpërmjet këtij Instrumenti, shfrytëzuesi duhet të hap ose të posedojë llogari bankare për qëllimet e projektit.
- (3) Fondi dhe aplikuesi për të cilin është marrë vendim për financim, lidhin Kontratë për ndarjen e mjeteve sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar nga Fondi.
- (4) Në rast se aplikuesit për të cilët është marrë vendim për financim, nuk e nënshkruajnë Kontratë për ndarjen e mjeteve në afatin e përcaktuar, Komiteti mund të kërkojë prej tyre në afate caktuar ta nënshkruajnë Kontratën.
- (5) Nëse aplikuesit për të cilët është marrë vendim për financim, nuk e nënshkruajnë Kontratë për ndarjen e mjeteve në afatin e përcaktuar, Komiteti sërish e shqyrton dhe/ose e ndryshon vendimin.

Pagesa e mjeteve

Neni 23

- (1) Të gjitha pagesat e Fondit dhe bashkëfinancimit të shfrytëzuesit, realizohen në llogari të posaçme bankare.
- (2) Fondi i paguan mjetet e ndara me këtë Instrument si paradhënie, në bazë tremujore sipas buxhetit të projektit, sipas Kontratës për ndarjen e mjeteve dhe dispozitat e kësaj rregullore.
- (3) Shfrytëzuesi i paguan mjetet nga bashkëfinancimi, sipas buxhetit të projektit, sipas Kontratës për ndarjen e mjeteve dhe dispozitat e kësaj rregullore.
- (4) Fondi i paguan mjetet e ndara me këtë Instrument për tremujorin e parë pas nënshkrimit të Kontratës për ndarjen e mjeteve, pasi shfrytëzuesi dorëzon pranë Fondi dëshmi për pagesën e realizuar për bashkëfinancim, për tremujorin e parë, në formë të certifikatës bankare nga llogaria bankare.
- (5) Pas nënshkrimit të Kontratës për ndarjen e mjeteve, shfrytëzuesi në afat prej 45 ditëve duhet të bëjë pagesë për bashkëfinancim për tremujorin e parë, në të kundërtën, Fondi ka të drejtë ta ndërpresë kontratën.
- (6) Fondi i paguan mjetet e ndara me këtë Instrument për çdo tremujor të ardhshëm pasi të plotësohen këto kushte:

- raport i miratuar tremujor për avancim në tremujorin paraprak (pjesa përshkruese dhe financiare);
- të shpenzuara të paktën 70% (shtatëdhjetë përqind) nga mjetet e buxhetuara paraprakisht;
- dëshmi të dërguar për pagesë të realizuar të bashkëfinancimit për tremujorin e radhës, në formë të certifikatës bankare nga llogaria e posaçme.

(7) Nga pagesa e fundit ndaj shfrytëzuesit nëpërmjet këtij Instrumenti, Fondi mban 5% (pesë përqind) nga buxheti i përgjithshëm i projektit.

(8) Procedura për pagesën e mjeteve të mbajtura sipas paragrafit (7) të këtij neni do të fillojë në afat prej 14 ditëve të punës, nga dita e miratimit të raportit përfundimtar të projektit (pjesa përshkruese dhe financiare)

(9) Në rast të mjeteve të pashpenzuara dhe/ose në rast të keqpërdorim, vlera përkatëse e mjeteve të mbajtura nuk do t'i paguhet shfrytëzuesit.

V. ZBATIMI I PROJEKTIT DHE MBIKËQYRJA

Rregullat e përgjithshme për zbatimin e projektit

Neni 24

(1) Shfrytëzuesi ka obligim ta zbatojë projektin sipas kushteve të përcaktuara në këtë rregullore dhe në Kontratën për ndarjen e mjeteve si dhe në pajtim me standardet dhe praktikat e mira teknike, ekonomike, financiare, drejtuese, ekologjike dhe sociale dhe në pajtim me aktet ligjore dhe nënljore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Shfrytëzuesi ka obligim ta zbatojë projektin në mënyrë efektive dhe efikase, në pajtim me aplikacionin e projektit dhe buxhetit të projektit.

(3) Shfrytëzuesi ka për obligim të mbajë evidencë financiare dhe të kontabilitetit, në pajtim me standardet e kontabilitetit, në mënyrë përkatëse për aktivitetet e projektit, burimet në dispozicion dhe shpenzimet lidhur me projektin dhe përgatit raporte financiare ndaj Fondit në pajtim me bazën e të hollave të gatshme, duke i paraqitur qartë dokumentet për shpenzimin e bërë dhe pagesat e tremujorit për të cilin referohen, në mënyrë përkatëse për aktivitetet, burimet dhe shpenzimet lidhur me projektin.

(4) Shfrytëzuesi dhe furnizuesit e zgjedhur, konsulentët dhe pjesëmarrësit në projekt duhet t'i përmbahen Ligjit të Parandalimit të Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, për parandalimin e korrupsionit dhe dukuritë e ngjashme gjatë zbatimit të kontratës.

Neni 25

(1) Shfrytëzuesi është i obliguar që rregullisht t'i shlyejë detyrimet ndaj Fondit.

(2) Në rast të pezullimit ose ndërprerjes së kontratës për ndarjen e mjeteve, Fondi e mban të drejtën t'i kërkojë shfrytëzuesit të kthejë një pjesë ose të gjitha mjetet e marra, në pajtim me kushtet e kontratës.

- (3) Pagesat e shfrytëzuesit në Fond duhet të bëhen në denarë.
- (4) Fondi do të mbajë evidencë për përmbushjen e obligimeve që shfrytëzuesit e fondeve i kanë ndaj Fondit.
- (5) Për çdo vonesë në pagesën e mjeteve për shlyerjen e obligimeve ndaj Fondit nga shfrytëzuesit më shumë se 30 (tridhjetë) ditë, Fondi i dërgon shfrytëzuesit paralajmërimin e parë me shkrim për vonesën.
- (5) Për çdo vonesë në pagesën e mjeteve për shlyerjen e obligimeve ndaj Fondit nga shfrytëzuesit më shumë se 60 (tridhjetë) ditë, Fondi i dërgon shfrytëzuesit paralajmërimin e dytë me shkrim për vonesën.
- (7) Për çdo vonesë në pagesën e fondeve për mbulimin e obligimeve ndaj Fondit nga shfrytëzuesit më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë, Fondi e mban të drejtën të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën për ndarjen e fondeve dhe të aktivizojë instrumentet e mbrojtjes. nëse ajo është paraparë.
- (8) Për çdo vonesë në pagimin e obligimeve ndaj Fondit nga shfrytëzuesit për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë, Fondi e mban të drejtën për llogaritjen dhe mbledhjen e normës ndëshkuese së interesit në pajtim me Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve të Republikës. të Maqedonisë së Veriut.

Furnizimi me mallra, shërbime dhe gjësende

Neni 26

- (1) Çdo furnizim të të mirave dhe shërbimeve, shfrytëzuesi e bën në pajtim m praktikat e përcaktuara të pranueshme komerciale, edhe atë:
- gjatë zbatimit të furnizimeve të parapara në projekt, shfrytëzuesit duhet t'i marrin parasysh nevojën ekonomike, efikasitetin, transparencën dhe kohëzgjatjen e procedurës së furnizimit si dhe cilësinë e të mirave dhe shërbimeve.
 - për furnizimet që tejkalojnë 10.000 (dhjetëmijë) euro, shfrytëzuesi duhet të zbatojë procedurë për mbledhjen e të paktën tre ofertave. Shfrytëzuesi pranë Fondit duhet të dorëzojë dokumentacion për miratim.
 - në raste të arsyetuara, furnizimet sipas paragrafit 2 të këtij neni mund të zbatohen edhe pa procedurën e përcaktuar, me miratim paraprak nga Fondi.
- (2) Kur është e zbatueshme, kontratat mes shfrytëzuesit dhe palëve të treta duhet të përfshijnë dispozita për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, parandalimin e konfliktit të interesave, revizionin dhe ndikimin ndaj mjedisit jetësorë.

Transparenca dhe komunikimi me opinionin

Neni 27

- (1) Shfrytëzuesi obligohet t'i ndjek udhëzimet e Fondit dhe Komitetit lidhur me transparencën dhe komunikimin e projektit ndaj opinionit sipas Udhëzimit për transparencë dhe komunikim të projekteve të Fondit.
- (2) Gjatë zbatimit të projektit, Shfrytëzuesi obligohet të gjitha materialet promovuese për projektin t'i shënjojë me logon dhe emrin e Fondit dhe qartë të theksojë se projekti zbatohet me mbështetje financiare të Fondit.
- (3) Pajisja që është marrë nëpërmjet projektit të financuar nga Fondi, detyrimisht duhet të shënjohej qartë me logon e Fondit dhe me vërejtjen: *“Mbështetur nga Fondi i Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut”*.
- (4) Nëse Shfrytëzuesi posedon ueb faqe, obligohet të publikojë informacion të shkurtër për mbështetjen financiare të siguruar nga Fondi.
- (5) Nëse Shfrytëzuesi publikon ose jep deklaratë për mediat lidhur me projektin, obligohet ta përmend mbështetjen e siguruar nga Fondi.

Ndryshimi i projektit dhe ridestini i mjeteve nga buxheti për projektin

Neni 28

- (1) Çdo ndryshim i projektit duhet të arsyetohet dhe të jetë në drejtim të arritjes së rezultateve të pritura të projektit.
- (2) Shfrytëzuesi obligohet që shpenzimet t'i realizojë me dinamikën dhe në suazat e shumave të përcaktuara në buxhetin e projektit.
- (3) Shfrytëzuesi ka të drejtë të bëjë ridestini të mjeteve mes normave buxhetore në vlerën e përgjithshme prej 15% (pesëmbëdhjetë përqind) nga buxheti i përgjithshëm i projektit për tërë kohëzgjatjen e projektit në drejtim të arritjes së rezultateve të pritura të projektit. Për ridestininin, Shfrytëzuesi e njofton Fondin në suazat e raporteve tremujore dhe raportin përmbyllës për projektin. Nëse gjatë një norme buxhetore në suazat e zbatimit të projektit mes shumës së paraparë fillestare dhe shumës së paguar, nuk do të konsiderohet si ridestini nëse ajo mbulohet me kursim nga ndonjë shpenzim tjetër në suazat e normës së tjetër buxhetore.
- (4) Çdo ndryshim i aplikacionit dhe buxhetit të projektit (ndryshime në planin e aktiviteteve, njerëzit kyç në projekt, ridestini i mjeteve në vlerë jo më shumë se 15% (pesëmbëdhjetë përqind) mes normave buxhetore nga buxheti i përgjithshëm i projektit, etj) duhet të miratohet paraprakisht nga Komiteti në bazë të kërkesës së dorëzuar nga Shfrytëzuesi, me shtojcë të reviduar të buxhetit të projektit.
- (5) Në rast të ridestinitimit të mjeteve të miratuara nga Fondi, Shfrytëzuesi obligohet t'i realizojë shpenzimet në pajtim me buxhetin e reviduar të projektit.

Ruajtja e dokumentacionit

Neni 29

(1) Shfrytëzuesi duhet ta ruajë dokumentacionin e plotë të projektit nga fillimi i zbatimit të projektit.

(2) Dokumentacioni i obligueshëm i projektit përmban:

- dokumentacionin e projektit dhe dokumentacionin në lidhje me shfrytëzuesin;
- të gjitha dokumentet zyrtare të komunikimit ndërmjet shfrytëzuesit dhe Fondit gjatë periudhës së aplikimit;
- njoftim për ndarjen e mjeteve;
- kontratë për ndarjen e mjeteve;
- të gjitha dokumentet zyrtare gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe gjatë obligimit për njoftim;
- kopjet origjinale të të gjitha raporteve të dorëzuara në Fond;
- njoftime për miratimin e raporteve të dorëzuara në Fond;
- kopje origjinale të të gjitha faturave; dhe
- të gjitha dokumentet e tjera dhe duke përfshirë kontratat me palët e treta dhe dëshmitë e tjera të pagesës në lidhje me projektin.

(3) Shfrytëzuesi ka për obligim ta ruajë dokumentacionin sipas paragrafit (1) të këtij neni, të paktën 10 vite pas përfundimit të projektit.

(4) Të gjitha informacionet rreth kontratave dhe furnizimeve lidhur me projektin duhet të jenë të disponueshme për punonjësit e Fondit dhe/ose personat e autorizuar nga Fondi.

VI. NDJEKJA DHE VLERËSIMI I REZULTATEVE TË PROJEKTIT

Qëllimet dhe metodat e ndjekjes dhe vlerësimit të rezultateve të projekteve

Neni 30

(1) Qëllimi i ndjekjes dhe vlerësimit të rezultateve të projekteve është që të ndiqet avancimi i projektit dhe zbatimi i aktiviteteve të planifikuara, të vërtetohet se shpenzimet e realizuara janë në pajtim me buxhetin e miratuar të projektit për periudhën e caktuar dhe sipas procedurave të Fondit si dhe të vlerësohen rezultatet e realizuara pas përfundimit të projektit.

(2) Metodatat e ndjekjes dhe vlerësimit të rezultateve të projekteve përfshijnë:

- shqyrtim dhe miratim të raporteve të dorëzuara nga shfrytëzuesi;
- vizita në terren të shfrytëzuesve;
- vlerësim të rezultateve të realizuara nga projekti dhe analizë e thellë afariste dhe financiare.

(3) Ndjekja dhe vlerësimi i rezultateve të projektit kryhet nga ekipet e ndjekjes të themeluar nga Fondi dhe/ose personal profesionalë për revizion të caktuar nga Fondi dhe/ose persona të jashtëm për revizion nga shoqëritë e autorizuar të revizionit, të përzgjedhur me vendim të Fondit me procedurë përkatëse.

Raportet

Neni 31

- (1) Shfrytëzuesi duhet pranë Fondit të dorëzojë raporte, edhe atë:
 - raportet tremujore të avancimit (pjesa përshkruese dhe pjesa financiare) që shfrytëzuesi i dorëzon për kohëzgjatjen e projektit brenda 14 (katërbëdhjetë) ditëve pas përfundimit të ditës së fundit kalendarike të tremujorit.
 - raport përfundimtar (pjesa përshkruese dhe pjesa financiare) që shfrytëzuesi e dorëzon brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas përfundimit të ditës së fundit kalendarike të projektit, dhe brenda së cilës periudhë shfrytëzuesi duhet gjithashtu t'i bëjë pagesat për të gjitha aktivitetet e projektit, përmbyllur me skadimin e ditës së fundit të kontratës për ndarjen e mjeteve
 - në 3 (tre) vitet e ardhshme pas përfundimit të projektit, më së voni deri më 31 mars të vitit aktual të dorëzojë raport vjetor për ndjekjen e aktiviteteve pas përfundimit të projektit.
- (2) Raportet tremujore, raporti përfundimtar dhe raporti vjetor për ndjekjen e aktiviteteve pas përfundimit të projektit, plotësohen në formularët e përgatitur nga Fondi.
- (3) Raportet shqyrtohen nga ekipet e ndjekjes dhe/ose personat profesional të revizionit, të emëruar nga drejtori i Fondit. Në rast të parregullsive të identifikuara në njoftimin që mund të korrigjohen nga ana e Shfrytëzuesit, Fondi e njofton Shfrytëzuesin për parregullsitë e identifikuara, me kërkesë për eliminimin e parregullsive dhe të dorëzojë raport të reviduar.
- (4) Në rast se raporti është i plotësuar në mënyrë përkatëse dhe është i disponueshën, Fondi e miraton raportin dhe miratimin e dorëzon deri te Shfrytëzuesi.
- (5) Ekipi i ndjekjes ka të drejtë nga Shfrytëzuesi të kërkojë informacione shtesë dhe dokumente lidhur me raportet si dhe të kryejë vizitë të paralajmëruar në terren të Shfrytëzuesit, për kontrollin e informacioneve të dorëzuara në raportet.

Vizita në terren

Neni 32

- (1) Fondi do të ndjek zbatimin e projektit dhe nëpërmjet vizitave në terren të shfrytëzuesve, të cilat do të kryhen nga ekipet e ndjekjes, personave profesionalë të revizionit, të emëruar nga Fondi dhe/ose anëtarët e Komitetit.
- (2) Është e obligueshme të kryhet të paktën një vizitë në terren për çdo projekt. Fondi ka të drejtë të kryejë më shumë vizita në terren nëse është e nevojshme.
- (3) Vizitat në terren përfshijnë vizitë në ambientet afariste të shfrytëzuesit dhe takim me njerëzit kyç të projektit me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të projektit (p.sh. respektimi i

procedurave, arritja e rezultateve të synuara, respektimi i kornizës kohore, respektimi i dispozitave të fondeve të kontratës për ndarjen e mjeteve, etj).

(4) Vizita në terren do të njoftohet. Fondi i dërgon shfrytëzuesit njoftim paraprak për kryerjen e vizitës në terren, që përmban detaje për vendndodhjen, orën e vizitës, personat që duhet të jenë të pranishëm, dokumentacionin dhe pajisjet e blera, të cilat duhet të jenë në dispozicion për inspektim. Njoftimi për realizimin e vizitës në terren dërgohet të paktën 3 (tri) ditë para realizimit të vizitës.

(5) Nëse Fondi e sheh të nevojshme, mund të kryejë vizitë të paparalajmëruar në terren.

(6) Për vizitën e kryer në terren, përpilohet raport që përfshin të dhëna për vizitën, personat që kanë marrë pjesë në vizitën në terren, dokumentacioni që është kontrolluar, vërejtjet që janë konstatuar nga vizita në terren, parregullsitë e evidentuara, udhëzimet dhe afatet për eliminimin e parregullsive të mundshme, etj.

(7) Shfrytëzuesit i dorëzohet raporti i vizitës në terren. Në rast të parregullsive, shfrytëzuesi është i obliguar të marrë masa në pajtim me udhëzimet dhe afatet e përcaktuara në njoftim. Fondi nuk do të kryejë pagesat e fondeve të ndara sipas këtij Instrumenti për tremujorin e ardhshëm derisa shfrytëzuesi t'i korrigjojë parregullsitë e mundshme të konstatuara në raport.

Veprimi në rast të parregullsive të vërtetuara

Neni 33

(1) Gjatë realizimit të projekteve, ekipet e ndjekjes, nëse konstatojnë parregullsi që mund t'i tejkalojnë kompetencat e tyre, mund t'i paraqesin propozim drejtorit të Fondit për thirrjen e mbledhjes së Komitetit për vendimmarrje në lidhje me parregullsitë e vërtetuara.

(2) Gjatë zbatimit të projekteve, në ndjekjen mund të përfshihen edhe

persona profesionalë të revizionit në pajtim me rregulloren për mënyrën e përfshirjes dhe punës së personave profesionalë të revizionit në punën e Fondit të Inovacionit dhe Zhvillimit Teknologjik dhe dhënien e mendimit profesional.

(3) Pas përfundimit të projektit, për vlerësimin e rezultateve dhe/ose analizën e thelluar afariste dhe financiare të projekteve të financuara, mund të angazhohen personal profesionalë të revizionit në pajtim me rregulloren për mënyrën e përfshirjes dhe punës së personave profesionalë të revizionit në punën e Fondit të Inovacionit dhe Zhvillimit Teknologjik dhe dhënien e mendimit profesional.

(4) Personi profesional i revizionit sipas paragrafit (2) dhe paragrafi (3) të këtij neni është i obliguar që të shqyrtojë dokumentacionin e projektit, të kryejë vizitë në terren te shfrytëzuesi (nëse është e nevojshme) dhe të dorëzojë raport dhe mendim profesional në Fond brenda afatit prej 14 ditëve të punës nga dita e marrjes së dokumentacionit.

Bashkëpunimi i shfrytëzuesit me Fondin

Neni 34

(1) Shfrytëzuesi obligohet t'u përmbahet procedurave dhe t'i mundësojë Fondi të kryejë ndjekje të lehtë dhe vlerësim mbi zbatimin e projektit.

(2) Shfrytëzuesi i mundëson Fondit ose personave të autorizuar nga Fondi në çdo kohë të kryejnë analizë të hollësishme për zbatimin e projektit, aktivitetet e tij dhe rezultatet e realizuara si dhe të kryejnë revizion të dokumentacionit të projektit dhe atij financiar lidhur me projektin. Shfrytëzuesi të gjitha dokumentet relevante lidhur me projektin duhet t'i përgatisë dhe dorëzojë pranë Fondit me kërkesë të tij.

Të drejtat dhe obligimet me rezultatin e projektit

Neni 35

(1) Shfrytëzuesi do t'i posedojë rezultatet e projektit që do t'i krijojë.

(2) Shfrytëzuesi merr masa për ta siguruar eksplotimin komercial të rezultateve të projektit, drejtpërdrejtë ose indirekt, në atë mënyrë që do t'i shfrytëzojë në hulumtime të tjera që nuk janë të mbuluara me këtë projekt, do të zhvillojë, krijojë ose plasojë në treg produkt ose proces, do të krijojë ose do të sigurojë shërbim ose do t'i shfrytëzojë për qëllimet e standardizimit dhe ai do t'i marrë këto masa në kohëzgjatjen e projektit deri në plotësimin e të gjitha obligimeve ndaj Fondit sipas kontratës për ndarjen e mjeteve.

(3) Shfrytëzuesi mund ta bartë pronësinë e rezultateve të projektit një palës tjetër, sipas kushteve të parapara në këtë nen.

(4) Shfrytëzuesi i cili synon që ta bartë pronësinë e rezultateve të projektit ose të japë licencë ekskluzive për shfrytëzimin e rezultateve të projektit palës tjetër, për këtë paraprakisht duhet ta informojë Fondin me shkrim para se të bëhet bartja e përmendur përkatësisht dhënie e licencës dhe të kërkojë pëlqim nga Fondi që të bëhet ajo. Në këtë informim me shkrim, shfrytëzuesi duhet të tregojë saktë cilët rezultate të projektit synon t'i bartë përkatësisht t'i kalojë dhe duhet të japë të dhëna të hollësishme për pronarin e ri përkatësisht shfrytëzuesin e licencës si dhe për eksplotimin e planifikuar ose potencial komercial të rezultateve të projektit ndërsa duhet të dorëzojë analizë të arsyetuar për ndikimin e mundshëm të bartjes ose dhënies së licencës ndaj konkurrencës së tregut dhe harmonizimin e saj me rregullat e mira etike dhe interesat e sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Fondi mund të kërkojë edhe informacione shtesë.

(5) Fondi mund të refuzojë të japë pëlqim për bartjen e planifikuar të pronësisë mbi rezultatet e projektit përkatësisht ndarjes së planifikuar të licencës ekskluzive për shfrytëzimin e rezultateve të projektit, sidomos:

- a) nëse pronari i ri përkatësisht shfrytëzuesi ekskluziv i licencës është shtetas i huaj ose subjekt juridik i themeluar jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- b) nëse Fondi vëren se bartja e planifikuar përkatësisht licencimi nuk është në pajtim me parimet e konkurrencës, me parimet e mira etike ose me interesat e sigurisë së

Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fondi e njofton shfrytëzuesin me shkrim për vendimin e vet lidhur me kërkesën sipas paragrafit (4) të këtij neni në afat prej 60 ditëve nga dita e pranimi të njoftimit përkatësisht nga dita e pranimi të çfarëdo informacioneve shtesë që Fondi mund t'i kërkojë. Fondi në vendimin e vet mund të imponojë kushte shtesë me të cilat bartja e planifikuar e pronësisë përkatësisht ndarja e planifikuar e licencës ekskluzive mund të zbatohet.

(6) Shfrytëzuesi nuk mund ta bartë pronësinë e rezultateve të projekteve ose të ndajë licencë ekskluzive për shfrytëzimin e rezultateve të projektit palës tjetër derisa nuk merr pëlqim nga Fondi përkatësisht derisa nuk i plotëson kushtet që Fondi mund t'i imponojë që të zbatohet bartja e planifikuar e pronësisë përkatësisht ndarja e planifikuar e licencës ekskluzive.

(7) Shfrytëzuesi patjetër duhet të sigurojë që pronari i ri i rezultateve të projektit do të obligohet t'i respektojë dispozitat e sipërpërmendura të këtij neni dhe se do të obligohet të sigurojë që çdo pronar i radhës i rezultateve të projektit të obligohet t'i respektojë dispozitat e kësaj rregulloreje.

(8) Obligimet e shfrytëzuesit të këtij neni vlejné për kohëzgjatjen e projektit si dhe deri në plotësimin e të gjitha obligimet ndaj Fondit, sipas kontratës për ndarjen e mjeteve.

(9) Nëse shfrytëzuesi vepron në të kundërtën nga dispozitat e këtij neni, Fondi e mban të drejtën të kërkojë nga shfrytëzuesi ta kthejë shumën e plotë ose një pjesë të shumës nga mjetet e ndara. Për këtë obligime, Fondi e mban të drejtën nga dita e pagesës që të përllogarit dhe paguajë normë ndëshkuese të interesit sipas Ligjit të Marrëdhënive të Detyrimeve.

Obligimet në rast të ndërprerjes së shfrytëzuesit

Neni 36

(1) Në rast të ndërprerjes së planifikuar (likuidimit) të shfrytëzuesit, shfrytëzuesi dorëzon kërkesë pranë Fondit dhe pas marrjes së lejes paraprake nga Fondi mund të fillojë procedurë për ndërprerje (likuidim). Pas kësaj kërkesë, Fondi merr vendim në afat sa më të shkurtër kohorë. Procedurë e këtillë e ndërprerjes (likuidimit) nuk guxon të nisë pa vendim me të cilin Fondi jep pëlqim paraprak për të.

(2) Nëse është dorëzuar propozim për fillimin e procedurës falimentuese kundër shfrytëzuesit, shfrytëzuesi me shkrim e njofton për këtë Fondi në afat prej 10 (dhjetë) ditë nga dijenia e propozimit të këtillë.

(3) Obligimet e shfrytëzuesit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni zgjasin në periudhë nga lidhja e kontratës për ndarjen e mjeteve mes Fondit dhe shfrytëzuesit deri në plotësimin e të gjitha obligimeve ndaj Fondit, sipas kontratës për ndarjen e mjeteve.

(4) Nëse në periudhën e caktuar në paragrafin (3) të këtij neni, shfrytëzuesi nisë procedurë për ndërprerje (likuidim) pa pëlqim paraprak të Fondit ose nuk e informon Fondin në afatin sipas paragrafit (2) të këtij neni për propozim të dorëzuar për fillimin e

procedurës falimentuese ndaj tij, Fondi mund të kërkojë nga shfrytëzuesi ta kthejë shumën e plotë ose një pjesë të shumës së mjeteve të ndara. Për këto obligime, Fondi mundet nga dita e mbërritjes deri në ditën e pagesës të përlogarisë dhe paguajë normë ndëshkuese interesi sipas Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve.

Ndryshimet në strukturën pronësore dhe ndryshimet statuse

Neni 37

(1) Nëse në periudhën e lidhjes së kontratës për ndarjen e mjeteve mes Fondit dhe shfrytëzuesit deri në plotësimin e të gjitha obligimeve ndaj Fondit sipas kontratës për ndarjen e mjeteve, bëhet ndryshimi i pronësisë së kapitalit, shfrytëzuesi obligohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e evidentimit të ndryshimit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ta njoftojë Fondi për ndryshimin e bërë.

Neni 38

(1) Në rast të ndryshimit të planifikuar statusor të shfrytëzuesit, shfrytëzuesi obligohet të dorëzojë kërkesë pranë Fondit dhe të marrë pëlqim paraprak nga Fondi që të mund të realizohet ndryshimi i këtillë i planifikuar. Pas kësaj kërkesë, Fondi obligohet të marrë vendim në afat sa më të shkurtër kohorë. Ndryshimi i këtillë i planifikuar nuk guxon të zbatohet me vendim me të cilin Fondi jep pëlqim paraprak për të.

(2) Nëse Fondi e miraton ndryshimin e planifikuar statusor të shfrytëzuesit, pronari i ri i shfrytëzuesit përkatësisht trashëguesi juridik i shfrytëzuesit obligohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas evidentimit të ndryshimit statusor në Regjistrin Qendrorë të Republikës së Maqedonisë së Veriut të lidhë me Fondin aneks të kontratës për ndarjen e mjeteve me të cilin i merr të drejtat dhe obligimet prej tij.

(3) Obligimi i shfrytëzuesit sipas paragrafit (1) të këtij neni zgjat në periudhën nga lidhja e kontratës për ndarjen e mjeteve mes Fondit dhe shfrytëzuesit deri në plotësimin e të gjitha obligimeve ndaj Fondit, sipas kontratës për ndarjen e mjeteve.

(4) Nëse në periudhën e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni, zbatohet ndryshimi statusor të shfrytëzuesit pa pëlqim paraprak nga Fondi, Fondi e mban të drejtën të kërkojë nga shfrytëzuesi ta kthejë shumën e plotë ose një pjesë të shumës nga mjetet e ndara. Për këto obligime, Fondi e mban të drejtën nga dita e mbërritjes deri në ditën e pagesës që të përlogarit dhe paguajë normë ndëshkuese të interesit, sipas Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve.

VII. Ndërprerja e financimit

Neni 39

Fondi e mban të drejtën që përkohësisht ta ndërpresë financimin në bazë të kontratës së lidhur për ndarjen e mjeteve, tërësisht ose pjesërisht, sidomos në këto raste:

- nëse kërkesa e shfrytëzuesit për pagesë nuk është në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore dhe/ose kontratës për ndarjen e mjeteve;
- nuk është dorëzuar asnjë raport që shfrytëzuesi duhet ta dorëzojë sipas dispozitave

të kësaj rregulloreje ose raporti i këtillë është jo i plotë ose nevojiten informacione shtesë;

- ekziston dyshim te Fondi për përshtatshmëri për financimin e shpenzimeve të paraqitura në raportet dhe nevojiten kontrolle shtesë;
- shfrytëzuesi ka kryer ose ka dyshim te Fondi se ka kryer shkelje serioze të obligimeve nga kontrata e ndarjes së mjeteve dhe/ose dispozitat e kësaj rregullore;
- shfrytëzuesi ka kryer ose ka dyshim te Fondi se ka kryer mashtrim, përfshirë edhe gjatë procedurës për ndarjen e mjeteve;
- në rast se është dorëzuar propozim për fillimin e procedurës falimentuese ndaj shfrytëzuesit.

Neni 40

(1) Nëse ndodh ndonjë rrethanë nga neni 39 i kësaj rregullore, Fondi e mban të drejtën të marrë vendim për ndërprerje të përkohshme të financimit dhe/ose të kërkojë kthimin e një pjese apo shumës së plotë të mjeteve të paguara ndaj shfrytëzuesit deri në atë moment.

(2) Fondi njëkohësisht me vendimin për ndërprerjen e përkohshme të financimit dërgon edhe njoftim me shkrim deri te shfrytëzuesi, ku e informon për shkeljet e bëra në kontratën për ndarjen e mjeteve, me kërkesë që shfrytëzuesi t'i eliminojë shkeljet në afat prej 14 (katërmëdhjetë) ditë nga dita e pranimin të njoftimit.

(3) Me kërkesë të shfrytëzuesit, Fondi mund t'i japë shfrytëzuesit 30 (tridhjetë) ditë shtesë për eliminimin e shkeljeve. Në raste të caktuara për të cilat pritet vendimi nga organi përkatës lidhur me punën e shfrytëzuesit e që ka ndikim ndaj ndërprerjes së përkohshme të financimit, afati i eliminimit të shkeljeve mund të vazhdohet deri në plotfuqishmërinë e vendimit nga ai organ.

(4) Në rast se shfrytëzuesi i eliminon shkeljet e identifikuar në afatet e përcaktuara në paragrafin (2) dhe (3) të këtij neni, Fondi merr vendim për tërheqjen e ndërprerjes së përkohshme të financimit.

(5) Në rast se shfrytëzuesi nuk i eliminon shkeljet e identifikuar në afatet e paragrafit (2) dhe (3) të këtij neni, Drejtori i Fondit e njofton Komitetin, i cili vendos nëse shkeljet kontrata. Sidoqoftë, Komiteti gjatë vendimit për shkeljet e Kontratës mund ta marrë parasysh shkallën e shfrytëzimit të projektit (avancimit dhe realizimit të projektit).

VIII. SHKËPUTJA E KONTRATËS PËR NDARJEN E MJETEVE

Neni 41

Fondi e mban të drejtën për shkëputjen e kontratës për ndarjen e mjeteve në tërësi apo pjesërisht, në rast të mashtrimit ose shkeljes së obligimeve nga kontrata për ndarjen e mjeteve dhe/ose dispozitat e kësaj rregullore në këto raste:

1. Nëse shfrytëzuesi nuk i shfrytëzon mjetet e miratuara financiare, duke përfshirë ridestinimin e mjeteve në përqindje më të madhe nga përqindja e vërtetuar e mjeteve nga buxheti i përgjithshëm i projektit sipas nenit 28;
2. Nëse shfrytëzuesi për qëllim të mashtrimit jep të dhëna të pasakta gjatë procedurës së ndarjes së mjeteve dhe për kohëzgjatjen e kontratës për ndarjen e

- mjeteve që kanë ndikim material në projekt;
3. Nëse shfrytëzuesi nuk zbaton politika dhe procedura përkatëse që do t'i mundësojnë Fondit të kryejë mbikëqyrje dhe ta vlerësojë avancimin e projektit
 4. Nëse shfrytëzuesi nuk zbaton dhe mban sistem të menaxhimit financiar dhe nuk përgatit raporte financiare në pajtim me standardet e kontabilitetit, që në mënyrë përkatëse do t'i reflektojë aktivitetet, burimet dhe shpenzimet lidhur me projektin;
 5. Nëse shfrytëzuesi me kërkesë të Fondit nuk lejon revizion nga revizori i pavarur dhe/ose personi profesional i revizionit i emëruar nga Fondi;
 6. Nëse shfrytëzuesi nuk i siguron Fondit dhe/ose personave të emëruar nga Fondi, të kryejnë qasje në zbatimin e projektit, aktivitetet e tij, rezultatet e realizuara dhe të gjitha dokumentet relevante të projektit, ose në llogari dhe/ose ato t'i dorëzojë pranë Fondit me kërkesë të tij;
 7. Nëse shfrytëzuesi nuk e informon Fondi për çdo ndryshim të rëndësishëm me ndikim material ndaj projektit;
 8. Nëse shfrytëzuesi vepron në të kundërtën e dispozitave nga neni 24 paragrafi 4 i kësaj rregullore që kanë të bëjmë me mashtrim dhe korrupsion;
 9. Nëse shfrytëzuesi vepron me rezultatet e projektit në kundërshtim me dispozitat e nenit 35 të kësaj rregullore.
 10. Nëse shfrytëzuesi nuk u përmbahet dispozitave të nenit 36, 37 dhe/ose 38 nga kjo rregullore në rast të ndryshimit të strukturës pronësore, ndryshimeve statusore dhe ndërprerjes;
 11. Në rast se është ngritur procedurë për nisjen e procedurës falimentuese ndaj shfrytëzuesit.

Neni 42

(1) Në rast se ndodh ndonjë nga rrethanat e nenit 41 të kësaj rregullore, Fondi e mban të drejtën të marrë vendim për shkëputjen e kontratës dhe/ose të kërkojë kthim të një pjese ose të mjeteve financiare në tërësi, që i janë paguar shfrytëzuesit deri në atë moment.

(2) Vendimin për shkëputjen e kontratës për ndarjen e mjeteve dhe financimin e merr Komiteti.

(3) Në rast të shkëputjes së kontratës, Fondi e mban të drejtën që të kthejë kthimin e sasisë së plotë ose të një pjese të vlerës së mjeteve që Fondi ia ka paguar shfrytëzuesit, sidomos në rastet kur ka të bëjë me kushtet e përmendura në nenin 41 paragrafi 1 nënparagrafët 2, 5, 6 dhe 8, Fondi e mban të drejtën që të kërkojë edhe kompensim të dëmit.

(4) Nëse kontrata për ndarjen e mjeteve shkëputet për çfarëdo arsye sipas nenit 41 ndërsa mjetet e ndara financiare nuk janë shpenzuar, shfrytëzuesi obligohet t'ia kthejë Fondit vlerën e plotë të pashpenzuar të mjeteve në afatin e përcaktuar nga Fondi, por jo më pak se 8 (tetë) ditë, në të kundërtën konsiderohet si vonesë dhe për sasinë e njëjtë mund të obligohet të paguajë normë ndëshkuese interesi sipas Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve, duke llogaritur nga dita e vonesës deri në pagesën përfundimtare.

(5) Nëse ndodhin kushtet sipas nenit 41, paragrafit 1 dhe nënparagrafët 9 dhe/ose 10 nga

kjo rregullore, Fondi e mban të drejtën të kërkojë nga shfrytëzuesi ta kthejë shumën e plotë ose të pjesëshme të mjeteve që Fondi ia ka paguar shfrytëzuesit. Nga dita e mbërritjes e deri në ditën e pagesës, Fondi e mban të drejtët të përlogarisë dhe paguajë normë ligjore të interesi sipas Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve.

(6) Fondi ka të drejtë të kërkojë normë ndëshkuese të interesit, kompensim të dëmit dhe të nisë procedurë përkatëse për sigurimin e kërkesave të shfrytëzuesit sipas kushteve të parapara në kontratë dhe rregullore, në afat sa më të shkurtër kohor, nëse shfrytëzuesi nuk i plotëson kushtet sipas paragrafit 3, 4 dhe 5 të këtij neni, që të bëhet kthimi i plotë i mjeteve tashmë të paguara ndaj shfrytëzuesit.

(7) Të gjitha pagesat duhet t'i paguhen Fondit në denarë sipas kursit zyrtar devizor blerës të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën e pagesës.

(8) Në çdo rast, Fondi gjatë vendimmarrjes për shkëputjen e kontratës mund ta marrë parasysh nivelin e shfrytëzimit të projektit (avancimit dhe realizimit të projektit).

Neni 43

(1) Fondi mund ta ndërpresë kontratën për ndarjen e mjeteve me kërkesë të shfrytëzuesit ose ekipit të ndjekjes, nëse për shkak të pengesës së paevitueshme nga aspekti teknik apo i tregut, vihen në pikëpyetje rezultatet e ardhshme të projektit.

(2) Në rastin sipas paragrafit (1) të këtij neni, Fondi do të kërkojë nga shfrytëzuesi të dorëzojë dokumentacion dhe të kërkojë ndërprerjen e projektit dhe financimit. Rrjedhimisht, Komiteti do të vërtetojë nëse ekziston arsyetim të dëshmime për ekzistimin e pengesës së paevitueshme që i vë në pikëpyetje rezultatet e ardhshme të projektit dhe do të marrë vendim përkatës. Nëse Komiteti vendos se janë plotësuar kushtet sipas paragrafit (1) të këtij neni, shfrytëzuesi nuk obligohet t'i kthejë mjetet e ndara.

IX. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 44

Për të gjitha çështjet që nuk rregullohen me këtë rregullore, do të vlejné dispozitat e dispozitave ligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 45

Ndaj kontratave për ndarjen e mjeteve, të lidhura me Fondin deri në ditën e hyrjes së rregullore në fuqi, do të zbatohen aktet përkatëse të Fondit sipas të cilave ato janë lidhur.

Neni 46

Me ditën e hyrjes së rregullores në fuqi, shfuqizohet rregullorja për instrumentin e mbështetjes - grantet e bashkëfinancuara për shoqëritë e sapoformuara tregtare start-up dhe spin-of, nr. 01-475/6 më 6.6.2018 dhe nr. 01-1425/14 më 4.7.2019.

Neni 47

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në tabelën e shpalljeve të Fondit, ndërkaq do të publikohet pas pëlqimit të marrë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. _____
_____ 2021
Shkup

Fondi i Inovacioneve dhe Zhvillimit
Teknologjik
Kryetarja e Këshillit Drejtues
Monika Jovanova